



REPUBLIKA E ALBANI
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BROSHURË PËR PRINDËRIT >>>

SHKOLLA TË SIGURTA

OFICERËT E SIGURISË NË SHKOLLA



Pse një program për sigurinë në shkollë?

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Akademia e Sigurisë dhe Urdhri i Psikologut po ndërmarrin projektin “Shkolla të sigurta – Oficerët e sigurisë në shkolla” i cili i jep një vëmendje të posaçme rritjes së sigurisë, si brenda ashtu edhe përreth shkollave.

Siguria në shkollë dhe lufta kundër dukurive të tilla, si episode të dhunës, përdorimi i drogave dhe i substancave abuzive, dukuria e bullizmit, siguria fizike në shkolla etj., janë prioritet i punës së shkollës për sigurimin e mirëqenies fizike dhe sociale të të rinjve.

Qëllimi i kësaj iniciative është garantimi i një mjedisi të nxëni të sigurt për fëmijët tuaj dhe për komunitetin e shkollës.

Çfarë janë oficerët e sigurisë në shkollë?

Oficerët e sigurisë në shkollë janë persona të përgatitur dhe të trajnuar:


- » për të parandaluar dhe për të menaxhuar rastet e krimit dhe të dhunës në shkollë;
- » për të bashkëpunuar me drejtorinë e shkollës, mësuesit, psikologun dhe anëtarë të tjerë të stafit për parandalimin dhe ndërhyrjen në rastet e:
 - thyerjes së disiplinës,
 - dhunës brenda shkollës,
 - ngacmimeve jashtë perimetrit të shkollës,
 - përdorimit të mjeteve të forta,
 - përdorimit të armëve të ftohta apo atyre të zjarrit,
 - përdorimit të lëndëve narkotike, duhanit, alkoolit,
 - menaxhimit të krizave,
 - emergjencave etj.;
- » për të mbështetur të rinjtë dhe prindërit në zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe në menaxhimin e konflikteve;
- » për të zhvilluar biseda (me të rinjtë, prindërit, mësuesit etj.) me qëllim ndërgjegjësimin dhe parandalimin e dukurive dhe kërcënimeve të mundshme, si: dhuna, bullizmi, shitja dhe përdorimi i substancave narkotike, trafikimi, siguria fizike etj.;
- » për të bashkëpunuar me institucionet e rendit, në përmbushje të sigurisë në shkollë.

Çfarë vlerash përcjellin oficerët e sigurisë në shkollë?

- » **Integritet, profesionalizëm dhe diskrecion.** Për vetë natyrën delikate të detyrës së oficerit të sigurisë, integriteti i lartë dhe profesionalizmi i tij janë vlera të panegociueshme.
- » **Shembull pozitiv.** Oficeri i sigurisë do të sjellë një nga rolet më me ndikim tek të rinjtë duke treguar shembullin personal pozitiv, si një individ me integritet, inkurajues për nxënësit dhe mbështetës me prindërit.
- » **Seriozitet në kryerjen e detyrës.** Oficeri i sigurisë do të marrë seriozisht të gjitha shqetësimet dhe do të ndjekë hapat e duhur për të ndërmarrë një veprim për sigurinë e fëmijëve.
- » **Ndërtim të marrëdhënieve të mira.** Oficeri i sigurisë do të nxisë dhe do të mbështesë një klimë bashkëpunuese me stafin e shkollës, psikologun e shkollës, oficerin e policimit në komunitet, prindërit, dhe veçanërisht nxënësit.

Cilat NUK janë detyra të oficerëve të sigurisë në shkollë?

- » Oficerët e sigurisë në shkollë nuk zëvendësojnë rolin e mësuesit në lidhje me përkujdesjen, mbikëqyrjen, sigurimin e disiplinës, rregullit dhe sigurisë në klasë, në shkollë e jashtë saj.
- » Oficerët e sigurisë nuk ndërmarrin masa disiplinore në shkollë, por raportojnë çdo shkelje të disiplinës së shkollës, pranë administratës së shkollës.
- » Oficerët e sigurisë nuk zhvillojnë kontrolle fizike apo të mjediseve, përveç rasteve të emergjencave dhe vendimit nga administrata e shkollës.



Çfarë u mundësojnë prindërve oficerët e sigurisë në shkollë?

- » Mbikëqyrje të vazhdueshme të nxënësve për parandalimin e problemeve në gjenezë.
- » Informacion për situatën e sigurisë në shkollë.
- » Raportime për ndodhinë dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, konflikteve apo dukurive të tjera që cenojnë sigurinë e jetës së fëmijëve, brenda dhe përreth shkollës.
- » Takime trajnuese për ndërgjegjësim rreth dukurive dhe kërcënimeve të mundshme të sigurisë në shkollë.
- » Adresim të rasteve, në marrëveshje me to, pranë psikologut të shkollës, punonjësit social ose pranë autoriteteve të specializuara.
- » Ndërmjetësim në komunikimin dhe lidhjen me policinë dhe shërbimet e tjera të komunitetit, në rast rreziku dhe nevoje.
- » Këshillim për çështje të zbatimit të ligjit.

